



# e - A l b a n i a

## PORTALI UNIK QEVERITAR

Ky dokument jep një përshkrim të detajuar të portalit unik qeveritar e-albania.al, përmbajtjes, organizimit dhe strukturës së tij.



## Hyrje

*Është data e fundit e muajit dhe nuk është paguar ende fatura e energjisë elektrike? Ju duhet karta e shëndetit por nuk keni kohë të prisni në sportel? Kërkoni të aplikoni për marrjen e një leje ndërtimi? Ju nevojitet të konsultoni pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi? Jeni duke hapur një biznes të ri dhe duhet të kryeni regjistrimin e tij? Kërkoni të konsultoni pikët tuaja të lejes së drejtimit, të paguani gjobat e automjetit apo të kontrolloni taksat e tij? Doni të shpëtoni nga radhët e gjata në sportele, të shmangni burokracitë, ryshfetet, vonesat?*

*Për të gjitha këto e shumë më tepër ju vjen në ndihmë portali unik qeveritar e-albania. Në kompjuter, celular e tablet, në versionet desktop dhe mobile. Mjafton të kryhet regjistrimi me numrin personal që gjendet në kartën e identitetit ose pasaportës dhe të zgjidhet shërbimi elektronik që nevojitet.*



## FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i versioneve dhe ndryshimeve të dokumentit

Versioni	Data	Përshkrimi
1.0	Shtator 2016	Publikimi i parë
1.1	Dhjetor 2016	



## Përmbajtja e dokumentit

1.	RRETH PORTALIT .....	6
2.	REGJISTRIMI NË PORTALIN E-ALBANIA .....	8
3.	PËRDORUESIT DHE MËNYRAT E IDENTIFIKIMIT NË PORTALIN QEVERTAR E-ALBANIA .....	10
4.	INFO TË DOBISHME .....	16
4.1.	Nivelet e shërbimeve .....	16
5.	PËRDORIMI I SHËRBIMEVE NË PORTALIN E-ALBANIA.....	18
5.1.	Përdorimi i shërbimeve duke përdorur fushën e kërkimit .....	19
5.2.	Përdorimi i shërbimeve duke përdorur kategoritë e shërbimeve sipas llojit të përdoruesve	21
5.2.1.	Shërbimet për qytetarë.....	22
5.2.2.	Shërbimet për biznese .....	22
5.2.3.	Shërbimet për administratën.....	22
5.3.	Përdorimi i shërbimeve duke përdorur kategoritë e shërbimeve .....	23
5.4.	Përdorimi i shërbimeve duke përdorur listën e institucioneve .....	25
5.5.	Pagesat elektronike.....	27
5.6.	Lista e shërbimeve që ofrohen aktualisht në portalin qeveritar e-albania .....	27
5.6.1.	Shërbime të maturës shtetërore .....	27
5.6.2.	Shërbime për zotëruesit e automjeteve .....	28
5.6.3.	Shërbime që lidhen me shëndetësinë dhe mirëqenien .....	29
5.6.4.	Shërbime që përfshijnë dokumente dhe certifikata .....	31
5.6.5.	Shërbime për zotëruesit e pronave .....	31
5.6.6.	Shërbime të kategorisë së qeverisjes vendore .....	32
5.6.7.	Shërbime për të cilat mund të kryhen pagesa online .....	32
5.6.8.	Shërbime që lidhen me gjurmimin e çështjeve .....	32
5.6.9.	Shërbime për pensionistët.....	33
5.6.10.	Shërbime për të punësuarit dhe të papunësuarit .....	34
5.6.11.	Shërbime OGP (Open Government Partnership - Partneriteti për Qeverisje të Hapur)	34
5.6.12.	Shërbime për bizneset .....	35
5.6.13.	Shërbimet e nivelit 1 dhe 2 .....	36
5.7.	Lista e shërbimeve që do të shtohen brenda muajit qershor 2017 në portalin qeveritar e-albania	36
6.	HAPËSIRA IME .....	36
7.	FORUMI.....	42
8.	APLIKACIONI MOBILE E-ALBANIA PËR iOS DHE ANDROID .....	43
9.	SPORTELET DIXHITALE E-ALBANIA .....	45



9.1.	Çfarë janë sportelet dixhitale e-albania dhe cilat janë përfitimet prej tyre? .....	45
9.2.	Vendndodhjet e sporteve dixhitale në Shqipëri .....	46
10.	PANELI I ADMINISTRIMIT NË BACKEND-IN E PORTALIT QEVERITAR E-ALBANIA .....	48
11.	INFRASTRUKTURA E PORTALIT.....	48



## 1. RRETH PORTALIT

Portal unik qeveritar e-albania është ndërtuar në kuadër të projektit IPA, me financim nga Bashkimi Evropian. Versioni i parë i tij është publikuar në ditën e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në 28 nëntor 2012. Në fazën e tij të parë, portali ka pasur kryesisht karakter informues ndaj qytetarit dhe deri në vitin 2013, ai ofronte në total 14 shërbime elektronike, shifër kjo që ka ardhur duke u rritur ndjeshëm në 3 vitet e fundit.

Portali unik qeveritar e-Albania është rinovuar tërësisht në vitin 2014 dhe ka ardhur me një dizajn të ri dhe më user friendly në versionin e tij të dytë, prezantuar në 19 maj 2015. Është përmirësuar dhe thjeshtëzuar ndërfaqja, duke e bërë më të lehtë regjistrimin, identifikimin dhe përdorimin e portalit për qytetarët, bizneset dhe punonjësit e administratës publike. Me versionin e ri të portalit është minimizuar, aty ku ka qenë i mundur, numri i hapave që duhen kryer për të arritur tek informacioni i kërkuar nga përdoruesi. Dizenjimi i menuve hierarkike e ka bërë më të lehtë për përdoruesin aksesimin e faqes së dëshiruar. Një element tjetër i rëndësishëm që është shtuar në versionin e ri të portalit është fusha e kërkimit të shërbimeve, duke u mundësuar përdoruesve të kërkojnë edhe me etiketime (tag) shërbimet e dëshiruara. Në “search box” mund të shkruhen vetëm 3 shkronjat e para të një fjale dhe sistemi do të rendisë të gjitha shërbimet që kanë lidhje me etiketimin e kërkuar. Është krijuar gjithashtu versioni mobile i portalit, i përshtatshëm për të gjitha versionet e sistemeve mobile operative (iOS, Android, Windows Mobile etj.), për t’iu ofruar përdoruesve një navigim më të lehtë përmes telefonit apo tabletit, dhe njëkohësisht janë krijuar aplikacionet e mirëfillta mobile për iOS dhe Android, të cilat janë të publikuara në dyqanet përkatëse, App Store dhe Google Play. Me versionin e ri të portalit, u shtuan një sërë funksionalitetesh të rëndësishme siç është mundësia e kryerjes së pagesave elektronike, në mënyrë të sigurt përmes Platformën Qeveritare të Pagesave Elektronike si dhe u përmirësua paneli i administrimit në backend duke shtuar funksionalite si akses të bazuar në role për punonjësit përgjegjës të institucioneve për shtimin/modifikimin e shërbimeve të institucionit të tyre në backend, historiku i ndryshimeve të kryera në një shërbim, ditari elektronik (newsletter), gjenerimi i raporteve mbi shërbimet/numrin e përdoruesve/përdorimin e shërbimeve elektronike etj.

### *Çfarë ofron e-Albania?*

- Është një zyrë me një ndalesë për shërbimet online të administratës publike;
- Është një kanal online për ofrimin e shërbimeve publike në 24 orë në 7 ditë të javës;
- Ofron shërbime elektronike të nivelit 3 dhe 4 (sipas klasifikimit UNPAN 2014 – shpjeguar në pikën 4.1) nëpërmjet standardeve më të fundit të teknologjisë, mundësi për kryerjen e pagesave online për këto shërbime nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit;
- Ofron shërbime elektronike të nivelit 1 dhe 2 (sipas klasifikimit UNPAN 2014 – shpjeguar në pikën 4.1), ku çdo i interesuar të marrë informacion të detajuar në lidhje me shërbimet për publikun (licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime të tjera të ngjashme), dokumentacionin e nevojshëm, procedurën që duhet të ndjekë, oraret e funksionimit dhe vendndodhjen e zyrave të administratës, kontaktet, si dhe adresën e faqes zyrtare të institucionit që ofron shërbimin përkatës, ku mund të orientohet për detaje të mëtejshme;



- Është në përputhje të plotë me politikat e qeverisë në fushën TIK dhe **strategjinë ndërsektoriale “Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020”**;
- Ofron mundësi komunikimi për çdo paqartësi, pyetje apo problem mbi regjistrimin, shërbimet e ofruara në portal, përmes forumit të portalit, postës elektronike, komenteve dhe mesazheve në rrjetet sociale;
- Ka përmirësuar ofrimin e shërbimeve, duke reduktuar kohën e marrjes së shërbimit, duke evituar burokracitë, si dhe duke ulur korrupsionin;
- Ofron informacion dhe shërbime elektronike që krijohen dhe mirëmbahen nga institucione të ndryshme publike dhe private. Disponueshmëria dhe saktësia e shërbimit është përgjegjësi e institucionit përgjegjës, i cili ofron shërbimin e tij elektronik përmes portalit;

#### *Cilët janë përdoruesit?*

- Të gjithë qytetarët shqiptarë dhe të huajt me regjistrim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- Bizneset e regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- Punonjësit e administratës publike në nivel qendror;
- Vizitorët e portalit.

#### *Standarde të përgjithshme të portalit*

- Ofron informacion mbi shërbimet që ofrojnë institucionet e administratës publike. Informacioni i paraqitur në portal përditësohet nga vetë institucionet sipas nevojës;
- Sigurohet disponueshmëri 24/7/365 me mbi 99% funksionalitet të tij;
- Lidhet me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway), në të cilën janë lidhur rreth 37 institucione të cilat shkëmbejnë të dhëna në kohë reale dhe së shpejti do të shtohen edhe 5 institucione të tjera;
- Sistemi i ndërveprimit është një sistem qendror shumëfunksional, një zgjidhje enterprise service bus me një arkitekturë të orientuar nga shërbimet;
- Pagesat e shërbimeve elektronike realizohen në mënyrë të sigurt nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave Elektronike, e cila është e lidhur me institucione bankare dhe jobankare;
- Ofron gërshetimin e një sërë teknologjive të sigurisë për të mbrojtur të dhënat e përdoruesve. Procesi i regjistrimit kryhet nëpërmjet portalit qeveritar dhe të dhënat e plotësuara, nga përdoruesit gjatë procesit të regjistrimit, verifikohen elektronikisht me të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile për individët dhe Regjistrimit Kombëtar Tregtar për Bizneset (QKB);
- Procesi i autentifikimit dhe identifikimit është i bazuar në strategjinë e "single-sign-on", për të krijuar një identitet unik për çdo përdorues, duke përdorur NID (numri personal i identifikimit) për qytetarin dhe NUIS për bizneset;



- Është në përputhje me versionet më të fundit të shfletuesve të internetit si Internet Explorer, Google Chrome, Mozilla Firefox, Safari etj;
- Aksesohet në versionet web, mobile, app mobile iOS dhe Android;
- Ofrohet 100% në gjuhën shqipe.

## 2. REGJISTRIMI NË PORTALIN E-ALBANIA

Në mënyrë që të përftoni shërbimet elektronike të ofruara nga portali qeveritar e-Albania duhet të identifikoheni në llogarinë tuaj në portal. Nëse regjistrimi nuk është kryer akoma, duhet patjetër të keni me vete kartën tuaj të identitetit në momentin e regjistrimit si dhe aparatin tuaj celular.

Për të huajt që kanë qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm, regjistrimi si qytetar është i mundur duke u regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe duke u pajisur me numrin e identitetit të shtetasve sipas procedurës: “Regjistrimi i Shtetasve të Huaj”: <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4695>

Pasi të jetë hapur portali [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al) vepohet si më poshtë:

Klikoni “Regjistrohu”:




Figura 1. Aksesimi i butonit të regjistrimit në portal

Plotësoni të gjitha të dhënat:



## Të dhënat e përdoruesit

Kodi i përdoruesit : ?

Fjalëkalimi (Minimumi 7 karaktere):

Fjalëkalimi përsëri :

e-mail :

Nr. Celularit:(Formati 06xxxxxxxx)

Pyetja e sigurisë :

Vendlindja e nënës

Përgjigje :

Emri :

Atësia :

Mbiemri :

Datëlindja : (Formati dd/MM/yyyy )

Unë miratoj përdorimin e të dhënave të mia personale

Lexo të plotë

**Regjistrohu**



Figura 2. Forma e regjistrimit në portal

**Kodi i përdoruesit:** Është numri personal i kartës suaj të identitetit.

**Fjalëkalimi:** Sigurohuni që fjalëkalimi të ketë te paktën 7 karaktere.

**e-mail:** Në këtë adresë do të vijjnë të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja.

**Numri i celularit:** Sigurohuni që të vendoset në formatin 06XXXXXXXX. Gjatë procesit të regjistrimit duhet ta keni me vete aparatit celular për të vendosur kodin me një përdorim të regjistrimit në hapin pasardhës.

**Të dhënat personale (Emër, Mbiemër, Atësi):** Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile.

**\*Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç". Emri, atësia dhe mbiemri duhet të vendosen të sakta, siç janë të regjistruara në Regjistrin e Gjendjes Civile (duke vendosur shkronjat ë ose ç nëse përfshihen në karaktere).**

Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin, kontaktoni me helpdesk-un në [login@e-albania.al](mailto:login@e-albania.al).

Për çdo individ që zotëron apo administron një biznes, e-Albania ofron mundësinë e regjistrimit të biznesit. Pasi të keni bërë regjistrimin si individ dhe të jeni identifikuar në portalin e-albania, në "Hapësira ime" ju mund të regjistroni biznesin tuaj, për t'u loguar më pas nëpërmjet numrit të identifikimit të biznesit dhe fjalëkalimit.

*\*Kujdes, për të regjistruar biznesin duhet patjetër të jeni loguar në portalin e-albania me llogarinë e personit i cili është administrator i biznesit.*

The image shows a web form titled "Regjistrimi i biznesit tuaj" (Your business registration). The form fields include:

- Të dhënat e biznesit (Business details)
- NUIS: (with an information icon)
- Fjalëkalimi (Minimumi 7 karaktere): (Password, minimum 7 characters)
- Fjalëkalimi përsëri: (Repeat password)
- e-mail:
- Nr. Celularit: (Formati 06xxxxxxxx) (Mobile number)
- Emri biznesit: (Business name)
- Pyetja e sigurisë: (Security question, dropdown menu with "Vendlindja e nënës" selected)
- Përgjigje: (Answer to security question)

To the right of the form is a sample of a "CERTIFIKATË REGJISTRIMI" (Registration Certificate). The certificate includes:

- NUMRI SERIAL: 82
- Personit të tatueshëm:
- Statusi: Aktiv
- Me adresë kryesore: Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkehojë nr.3, Rruga Jordan Misja
- I jepet ky numër identifikimi (NUIS): XXXXXXXX (circled in red)
- Adati i veprimtarisë: Një ditë
- DATA E REGJISTRIMIT: 18.06.2015
- DATA E LËNDIMIT: 18.06.2015
- SPORTELLI I SHËRIMET: (Stamp)
- QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Figura 3. Forma e regjistrimit të biznesit në portal

Informacionin mbi regjistrimin në portalin qeveritar e-Albania gjendet gjithashtu në linkun: <https://e-albania.al/regjistrimi.aspx>

### 3. PËRDORUESIT DHE MËNYRAT E IDENTIFIKIMIT NË PORTALIN QEVERITAR E-ALBANIA

Të gjitha format e regjistrimit dhe identifikimit në portalin qeveritar e-Albania janë të shoqëruara me info (i) sqaruese.

Figura 4. (i)-të sqaruese në portal

Në portalin e-Albania ka tre lloje përdoruesish: punonjës qeveritar, qytetar dhe biznes si dhe pesë mënyra të ndryshme identifikimi:

### 1. Identifikimi i punonjësit qeveritar:

- a) Mënyra e parë e identifikimit bëhet nëpërmjet të njëjtave kredenciale: emër,mbiemër dhe fjalëkalim, që përdoren për aksesimin në hapësirën e kompjuterit dhe e-mail-it (gov.al) të institucionit qeveritar ku personi punon. Kjo mënyrë identifikimi u lejon të gjithë punonjësve të Kryeministrit, ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë, të cilat janë të përfshira në domain-in "gov.al" në Active Directory-në, e cila administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Figura 5. Identifikimi i punonjësve qeveritarë me fjalëkalim

- b) Mënyra e dytë e identifikimit për përdoruesin e tipit “Punonjës qeveritar” është nëpërmjet certifikatës. Sipas VKM Nr. 703, datë 29.10.2014 AKSHI zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila ndër të tjera përbëhet nga: çelësi publik dhe menaxhimi i certifikatave dixhitale për administratën publike. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, AKSHI siguron pajtueshmërinë me nenin 19, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”. Punonjësit qeveritarë pajisen me një USB token, me anë të së cilit mund të identifikohen dhe logohen në portal.

Ju lutem zgjidhni mënyrën e identifikimit:

Identifikimi i qytetarëve/bizneseve me fjalëkalim	①
Identifikimi i punonjësve qeveritarë (GOV)	①
Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certifikatë	①
Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certifikatë Identifikimi bëhet nëpërmjet usb token, në të cilën është instaluar çelësi publik dhe certifikata dixhitale për administratën publike, e lëshuar nga AKSHI për punonjësit qeveritarë. Ky shërbim kërkon browser Internet Explorer ose Edge.	
Identifikimi i qytetarëve me kartë identiteti	①

Nëse nuk keni një llogari si përdorues qytetar/biznes, ju duhet të regjistroheni në portal **Regjistrohu**

Figura 6. Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certifikatë

Më tepër rreth kësaj mënyre identifikimi: <https://e-albania.al/imazhe/Manual-Identifikimi-i-punonjesve-qeveritare-me-certifikate-elektronike.pdf>

## 2. Identifikimi i përdoruesit biznes:

Identifikimi i përdoruesit biznes bëhet nëpërmjet NUIS dhe fjalëkalimit.

**Ju lutem vendosni kredencialet tuaja në platformën qeveritare të ndërveprimit.**

**Informacioni i llogarisë**

Kodi i përdoruesit (Qytetar/Biznes): ?

*Nëse duhet të hyni si përdorues qytetar, në fushën më sipër duhet të vendosni numrin personal NID*



*Nëse duhet të hyni si përdorues biznesi, në fushën më sipër duhet të vendosni NUIS (NIPT) të biznesit*



Fjalëkalimi: ?

*Kujdes, nëse fjalëkalimi vendoset tre herë gabim, do të bllokohet llogaria për 3 orë! Për më tepër informacion vizitoni: <https://e-albania.al/aksesimi.aspx>*

**IDENTIFIKOHU**

Figura 7. Identifikimi i bizneseve

### 3. Identifikimi i përdoruesit qytetar:

- a) Mënyra e parë e identifikimit bëhet nëpërmjet numrit personal në kartën e identitetit të shtetasve dhe fjalëkalimit. Për të huajt që kanë qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm, që ata të mund të identifikohen në portal, duhet të regjistrohen paraprakisht si qytetarë në Regjistrin e Gjendjes Civile duke u pajisur me numrin e identitetit të shtetasve.

**Ju lutem vendosni kredencialet tuaja në platformën qeveritare të ndërveprimit.**

**Informacioni i llogarisë**

Kodi i përdoruesit (Qytetar/Biznes): ?

*Nëse duhet të hyjni si përdorues qytetar, në fushën më sipër duhet të vendosni numrin personal NID*



*Nëse duhet të hyjni si përdorues biznesi, në fushën më sipër duhet të vendosni NUIS (NIPT) të biznesit*



Fjalëkalimi: ?

*Kujdes, nëse fjalëkalimi vendoset tre herë gabim, do të bllokohet llogaria për 3 orë! Për më tepër informacion vizitoni: <https://e-albania.al/aksesimi.aspx>*

**IDENTIFIKOHU**

Figura 8. Identifikimi i qytetarëve me NID dhe fjalëkalim

**Kujdes, nëse fjalëkalimi vendoset tre herë gabim, llogaria do të bllokohet për tre ore.** Për të bërë zhblokimin e llogarisë kontaktoni në [login@e-albania.al](mailto:login@e-albania.al).

Nëse nuk e mbani mend fjalëkalimin, për të vendosur një fjalëkalim të ri, klikoni “Harruat fjalëkalimin?”. Ndiqni udhëzimet dhe përgjigjuni “Pyetjes së sigurisë” që e keni zgjedhur kur keni bërë regjistrimin në portal.

Nëse nuk e mbani mend “Pyetjen e sigurisë” apo vazhdoni të keni probleme me aksesimin e portalit kontaktoni në [login@e-albania.al](mailto:login@e-albania.al) duke kërkuar gjenerimin e fjalëkalimit, ose në çdo moment mund të klikoni **“Ndhmë dhe suport”**, e cila gjendet në të gjitha ndërfaqet e portalit.



Figura 9. Aksesimi i ndihmës dhe suportit

- b) Mënyra e dytë e identifikimit për përdoruesin e tipit “Qytetar” është nëpërmjet lexuesit të kartës së identitetit. Për të përdorur shërbimet elektronike nëpërmjet kësaj mënyre identifikimi, zotëruesi i kartës së identitetit duhet të ketë të aktivizuar kartën e tij të identitetit. Nëse nuk e ka, kompania ‘Aleat’ ofron shërbimin e aktivizimit të kartës së identitetit në çdo pikë të shërbimit ‘Aleat’ në të gjithë Shqipërinë. Pasi të jetë bërë aktivizimi, për të përdorur elektronikisht kartën e identitetit, nevojitet një lexues karte. Lexuesi i kartës lejon që kompjuteri të komunikojë me mikroçipin në kartën e identitetit. Për më tepër informacion mbi aktivizimin e kartës së identitetit dhe lexuesve të kartës vizitoni <http://aleat.al/al/aktivizim-karte>.

Ju lutem zgjidhni mënyrën e identifikimit:

- Identifikimi i qytetarëve/bizneseve me fjalëkalim ⓘ
- Identifikimi i punonjësve qeveritarë (GOV) ⓘ
- Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certifikatë ⓘ
- Identifikimi i qytetarëve me kartë identiteti ⓘ

Identifikimi i qytetarëve me kartë identiteti

Identifikimi bëhet nëpërmjet kartës së identitetit dhe lexuesit të kartës. Për të përdorur shërbimet elektronike nëpërmjet kësaj mënyre identifikimi, zotëruesi i kartës së identitetit nëse nuk e ka aktivizuar atë duhet ta aktivizojë pranë Zyrave të Shërbimit Aleat (G/C). Për më tepër informacion mbi aktivizimin e kartës së identitetit dhe lexuesve të kartës vizitoni:

ALEAT Aktivizim Karte



Nëse nuk keni një llogari si përdorues qytetar/biznes, ju duhet të regjistroheshi në portal [Regjistrohu](#)

Figura 10. Identifikimi i qytetarëve me kartë identiteti

Informacioni mbi përdoruesit mënyrat e identifikimit në portalin qeveritar e-Albania gjendet në: <https://e-albania.al/identifikimi.aspx>



## 4. INFO TË DOBISHME

Në hapësirën “Info të dobishme” përdoruesit mund të informohen rreth portalit qeveritar e-Albania, mund të marrin ndihmë mbi përdorimin e portalit, apo informacion mbi numrat e dobishëm, datat e ndryshme si edhe nivelit e shërbimeve.



Figura 11. Aksesimi i menisë “Info të dobishme” në faqen kryesore të portalit

Më tepër detaje rreth menisë “Info të dobishme” në portalin qeveritar e-Albania gjenden në: <https://e-albania.al/info.aspx>

### 4.1. Nivelet e shërbimeve

Në rubrikën “Info të dobishme” gjenden gjithashtu të shpjeguara nivelet (1, 2, 3 dhe 4) e shërbimeve (sipas klasifikimit UNPAN 2014). Nivelet e shërbimeve janë të shpjeguara më poshtë.






Figura 12. Aksesimi i "Niveleve të shërbimeve" në menunë "Info të dobishme"



### Niveli 1: Shërbimet informuese në zhvillim

Faqet qeveritare në internet ofrojnë informacione mbi politikat publike, qeverisjen, ligjet, rregullat, dokumentacionet përkatëse dhe llojet e shërbimeve qeveritare të ofruara. Ato përmbajnë lidhje që të çojnë në faqet e ministrive të linjës, departamenteve dhe degëve të tjera të qeverisë. Qytetarët kanë mundësi të marrin informacion të përditësuar nga qeveria dhe ministrive të saj, si dhe të ndjekin lidhjet për të marrë informacion.



### Niveli 2: Shërbimet informuese të përmirësuara

Faqet qeveritare në internet ofrojnë komunikim elektronik të përmirësuar njëdrejtimësh ose të thjeshtë dydrejtimësh mes qeverisë dhe qytetarit, si për shembull formularë të shkarkueshëm për shërbimet dhe aplikimet qeveritare. Këto faqe kanë opsione në audio dhe video, si dhe janë shumëgjuhëshe. Disa shërbime elektronike të kufizuara iu mundësojnë qytetarëve të dërgojnë kërkesa për formularët jo-elektronikë ose informacione personale.



### Niveli 3: Shërbimet e transaksioneve

Faqet qeveritare në internet ofrojnë komunikim dydrejtimësh me qytetarët, duke përfshirë kërkimin dhe marrjen e të dhënave mbi politikat qeveritare, programet, rregullat etj. Në këtë rast, kërkohen disa forma të autentifikimit elektronik të identitetit të qytetarit, në mënyrë që të realizohet shkëmbimi. Faqet qeveritare përpunojnë transaksione jofinanciare, si për shembull regjistrimin e taksave online apo aplikimin për certifikata, licenca dhe leje. Ato realizojnë edhe transaksione financiare, p.sh në rastin kur paratë transferohen përmes një rrjeti të sigurt.



#### Niveli 4: Shërbimet e lidhura

Faqet qeveritare në internet kanë ndryshuar mënyrën se si qeveria komunikon me qytetarët. Ato janë proaktive në kërkimin e informacionit dhe opinioneve të qytetarëve duke përdorur Web 2.0 dhe mjete të tjera interaktive. Shërbimet elektronike dhe zgjidhjet elektronike kalojnë nëpër departamente dhe ministri në një mënyrë të unifikuar; informacioni, të dhënat dhe faktet transferohen nga agjencitë qeveritare përmes aplikacioneve të integruara.

*Informacioni mbi nivelet e shërbimeve në portalin qeveritar e-albania gjendet edhe në linkun: <https://e-albania.al/nivelet.aspx>*

## 5. PËRDORIMI I SHËRBIMEVE NË PORTALIN E-ALBANIA

Pasi përdoruesi identifikohet në e-albania duke klikuar “Hyr” në faqen kryesore, ai mund të përdorë shërbimin që dëshiron duke e kërkuar atë në fushën e kërkimit ose në kategoritë e shërbimeve si dhe duke klikuar butonin “**Përdor**” në krah të çdo shërbimi elektronik.

Për shërbimet elektronike të nivelit 3 dhe 4 është i nevojshëm identifikimi (përveç rasteve të shërbimeve OGP, shpjeguar më poshtë), për shkak se është i nevojshëm ndërveprimi i sistemeve të institucioneve për t’i ofruar përdoruesit një shërbim të personalizuar.

Për shërbimet e nivelit 1 dhe 2 nuk është i nevojshëm identifikimi, pasi ato i përkasin kategorisë së shërbimeve informuese të cilat nuk përfshijnë ndërveprim.

### 5.1. Përdorimi i shërbimeve duke përdorur fushën e kërkimit

Përdoruesi mjafton të shtypë në fushën e kërkimit 3 shkronja nga emërtimi i shërbimit dhe do t'i shfaqet lista e shërbimeve që përkojnë me ato shkronja:




Figura 13. Kërkimi i shërbimeve nëpërmjet fushës së kërkimit në portal

Në ndihmë të përdoruesit, në rastet kur ai nuk e di me saktësi emërtimin e shërbimit që kërkon të aksesojë, vijnë etiketimet (tags) e shërbimit. Për shembull, në fushën e kërkimit të shërbimit përdoruesi që kërkon shërbimin e gjenerimit të pikëve të leje drejtimit, mund të shkruajë fjalën “patentë” dhe menjëherë do të afishohet lista e shërbimeve që kanë lidhje me leje drejtimit ose patentën, siç i referohemi shpesh në jetën e përditshme (në këtë rast do të zgjedhë shërbimin “Pikët e drejtuesit të mjetit”).



Figura 14. Përdorimi i etiketimeve (tags) në fushën e kërkimit



Për të aksesuar shërbimin e faturës së energjisë elektrike, sërish duke përdorur fushën e kërkimit përdoruesi mund ta gjejë shërbimin duke shkruar “drita” dhe menjëherë do të shfaqet shërbimi “Faturat e energjisë elektrike”

Gjithashtu shërbime të caktuara janë të shoqëruara edhe me info **(i)** sqaruese për përdoruesit më qëllim evitimin e konfuzionit gjatë aplikimit për marrjen e një shërbimi. Psh, nëse nuk e dini me saktësi se cili është “kodi i klientit” në faturën e energjisë elektrike, mjafton të klikohet butoni (i) dhe menjëherë do të shfaqet seksioni se ku mund të gjendet kodi i klientit në faturën e energjisë elektrike.

**OSHEE** OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE

Të dhëna nga  
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Kodi i Klientit: **(i)**

**FATURË TATIMORE**

**Janar 2015**  
(datë: 17.01.2015)

<b>KODI I KLIENTIT</b>	TRD1234567890
<b>NUMRI I FATURËS</b>	1234567
<b>PERIUDHË FATURIMI</b>	11.12.2014 - 11.01.2015
<b>NUMRI I MATËSIT</b>	1234567
<b>NUMRI I VULËS</b>	1234567

Informacioni i mësipëri... ncia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit -

Figura 15. Përdorimi i (i)-ve informuese në faqet e shërbimeve





5.2. Përdorimi i shërbimeve duke përdorur kategoritë e shërbimeve sipas llojit të përdoruesve




Figura 16. Aksesimi i listës së plotë të shërbimeve nga faqja kryesore

Pasi klikohet menuja e-Shërbime në faqen kryesore, shërbimet janë të ndara në kategoritë: të gjitha, për qytetarë, për biznese, për administratën.




Figura 17. Aksesimi i shërbimeve sipas kategorive të përdoruesve

### 5.2.1. Shërbimet për qytetarë

Për të përdorur shërbimet elektronike “Për qytetarë”, përdoruesi duhet të jetë identifikuar si *qytetar* në portalin e-albania nëpërmjet numrit personal të kartës së identitetit dhe fjalëkalimit.

### 5.2.2. Shërbimet për biznese

Për të përdorur shërbimet elektronike “Për biznese”, përdoruesi duhet të jete identifikuar si *business* në portalin e-albania nëpërmjet NIPT dhe fjalëkalimit.

### 5.2.3. Shërbimet për administratën

Për të përdorur shërbimet elektronike “Për administratën”, përdoruesi duhet të jetë identifikuar si *punonjës qeveritar* në portalin e-albania nëpërmjet të njëjtave kredenciale: emër.mbiemër dhe fjalëkalim, që përdoren për aksesimin në hapësirën e kompjuterit dhe email-it (gov.al) të institucionit qeveritar ku punon.

### 5.3. Përdorimi i shërbimeve duke përdorur kategoritë e shërbimeve

Duke klikuar në menunë “Kategori” në faqen kryesore të portalit, përdoruesi ka mundësi të shfletojë shërbimet bazuar në temën së cilës ato i përkasin.




Figura 18. Aksesimi i kategorive të shërbimeve

Përdoruesi zgjedh kategorinë që dëshiron të shfletojë dhe menjëherë i shfaqet lista e shërbimeve që i përkasin kategorisë së përzgjedhur.





Figura 19. Lista e kategorive të shërbimeve në portal



#### 5.4. Përdorimi i shërbimeve duke përdorur listën e institucioneve

Përdoruesi mund t'i aksesojë shërbimet edhe sipas institucioneve, përmes dy mënyrave (siç tregohet në fotot e mëposhtme):

- Duke klikuar menunë “Institucionet” në faqen kryesore.



Figura 20. Aksesimi i listës së institucioneve përmes faqes kryesore

- Duke klikuar ikonën me imazhin e animuar të institucioneve në çdo nënfaqe të portalit.




Figura 21. Aksesimi i listës së institucioneve përmes nënfaqeve të portalit

Institucionet mund të aksesohen përmes listës ose hartës, si te figura e mëposhtme.




Figura 22. Aksesimi i listës dhe hartës së institucioneve

Duke zgjedhur opsionin e listës, përdoruesi ka mundësi të shohë listën e gjithë institucioneve publike të Shqipërisë, të ndara sipas ministrive të linjës. Duke klikuar butonin “Shiko shërbimet e këtij institucioni”, mund të shihen të gjitha shërbimet e institucionit në fjalë në portalin qeveritar. Përmes butonit “Shiko institucionet në varësi” përdoruesi mund të shohë listën e institucioneve në varësi të institucionit të përzgjedhur. Duke klikuar butonin “Hyr” në të djathtë, përdoruesi mund të marrë informacion të detajuar mbi institucionin, si kontaktet, faqen zyrtare të internetit etj.




Figura 23. Aksesimi i listës së institucioneve

## 5.5. Pagesat elektronike

Përdoruesit e portalit unik qeveritar e-albania nëpërmjet **Platformës Qeveritare të Pagesave Elektronike** mund të kryejnë pagesa online për shërbimet elektronike si faturat e energjisë elektrike, kundërvajtjet rrugore, pagesa për aplikime etj. Aktualisht në portalin unik qeveritar e-albania ekzistojnë dy kanale alternative të shërbimit bankar për ofrimin e pagesave elektronike dhe një kanal jo-bankë, i cili ofron pagesa online.

Për cilindo që zotëron një kartë krediti ose debiti me logon Visa ose MasterCard, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, portali unik qeveritar e-albania ofron mundësinë e kryerjes së pagesave online nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave Elektronike thjesht dhe shpejt, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës. Platforma Qeveritare e Pagesave Elektronike ofron garanci dhe siguri maksimale, lehtësi dhe shpejtësi në veprime, pa qenë nevoja të paraqiteni pranë sporteleve, duke kursyer në këtë mënyrë kohën dhe radhët e gjata të pritjes.

Procedura është mjaft e thjeshtë dhe e shpejtë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Pasi të keni hyrë në llogarinë tuaj në portalin unik qeveritar e-albania, zgjidhni shërbimin, klikoni butonin “Përdor” dhe më pas butonin “Paguaj”.
- Në vijim zgjidhni mënyrën e pagesës nëpërmjet kanalit të dëshiruar bankar, konfirmoni shumën e pagesës për shërbimin e zgjedhur, dhe ndiqni udhëzimet për të plotësuar të dhënat e kartës dhe për të kryer pagesën.
- Në rastin e përzgjedhjes të kanalit jo-bankë, ju duhet të keni krijuar një llogari personale tuajën dhe ta keni kredituar atë, e më pas ju mund t’i përdorni këto para për të kryer veprime të cilat jua mundëson platforma qeveritare e pagesave elektronike.

Informacioni mbi pagesat elektronike në portalin qeveritar e-Albania gjendet në: <https://e-albania.al/paymentgatewayinfo.aspx>

## 5.6. Lista e shërbimeve që ofrohen aktualisht në portalin qeveritar e-albania<sup>1</sup>

Aktualisht në portalin qeveritar e-albania ofrohen mbi 278 shërbime elektronike dhe mbi 570 shërbime informative. Më poshtë paraqiten disa prej shërbimeve më të përdorura elektronike.

### 5.6.1. Shërbime të maturës shtetërore

- ✚ Nëpërmjet shërbimit elektronik **“Matura Shtetërore”**, të gjithë maturanët/kandidatët aplikojnë online për formularët A1 dhe A1Z. Shërbimi funksionon bazuar në udhëzimin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS). Pas identifikimit dhe klikimit të butonit “Përdor”, maturanti/kandidati zgjedh llojin e formularit të aplikimit (në varësi të vitit të mbarimit të shkollës së mesme). Pasi përfundon me sukses aplikimin në



Figura 24. Logoja e kategorisë “Arsim” në portal

<sup>1</sup> Shtator 2016



portalin e-albania, maturanti/kandidati paraqitet pranë shkollës për të përfunduar aplikimin. Aplikimi me formularin A1/A1Z bëhet në data të caktuara të cilat përcaktohen nga MAS.

Plotësimi i formularëve A1/A1Z mundëson ruajtjen e të dhënave personale si dhe provimet të cilave do t'u nënshtrohet maturanti (ose mbarten notat në rast se ka dhënë një ose më shumë provime). Pas plotësimit të formularit bëhet korrigjimi i pasaktësive. Në periudhën maj-qershor zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore. Pikët hidhen në sistem dhe konvertohen në nota provimesh. Maturantët që rezultojnë kalues në të gjitha provimet pajisen me diplomë të Maturës Shtetërore.

- ✚ Shërbimi elektronik **[“Notat e provimeve të maturës”](#)** u vjen në ndihmë të gjithë maturantëve që duan të shohin rezultatet e provimeve me detyrim dhe me zgjedhje që kanë dhënë në përfundim të maturës, duke filluar nga matura 2012. Gjithashtu, nëpërmjet këtij shërbimi ofrohet mundësia e shkarkimit të rezultateve në formën e një diplome.

#### 5.6.2. Shërbime për zotëruesit e automjeteve

- ✚ Personat që zotërojnë një leje drejtimi mund të konsultojnë në kohë reale gjendjen e pikëve të lejes së tyre të drejtimit përmes shërbimit elektronik **[“Pikët e drejtuesit të mjetit”](#)** ku mund të shkarkohen gjithashtu tabela e pikëve që zbriten për çdo shkelje të normave të sjelljes.



Figura 25. Logoja e kategorisë "Transport" në portal

- ✚ Vlerat e taksave të automjeteve ndryshojnë në varësi të tyre, prandaj, për t'ua lehtësuar dhe shpejtuar zotëruesve të mjeteve procesin e llogaritjes së vlerës së tyre, portali qeveritar e-albania ka vendosur në dispozicion të qytetarëve dhe bizneseve shërbimin **[“Taksat e automjeteve”](#)**. Nëpërmjet këtij shërbimi elektronik, zotëruesit e automjeteve mund të konsultojnë në kohë reale vlerën vjetore të taksave të automjeteve të tyre.

#### ✚ Kontrolli dhe pagesa e gjobave

- Të gjithë drejtuesit e mjeteve kanë mundësi të verifikojnë dhe kontrollojnë online kundërvajtjet rrugore të kryera gjatë përdorimit të mjetit, që janë ende të pashlyera, përmes shërbimit **[“Kundërvajtjet rrugore”](#)** në portalin qeveritar e-albania. Gjithashtu, e-albania ofron mundësinë për të bërë pagesa online nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave Elektronike, në mënyrë të sigurt me kartat e debitit/kreditit VISA ose MASTERCARD ose kanaleve jo-bankare.
- **[“Gjobat e kontrollit në rrugë nga DPSHTRR”](#)** është një shërbim elektronik, i cili u mundëson zotëruesve të automjeteve të shohin online gjobat e kontrollit në rrugë të DPSHTRR-së dhe nëse kanë të tilla (do të mund të shikoni të gjitha gjobat e papaguara për kundërvajtje rrugore të cilat janë pasqyruar në sistemin e Policisë së Shtetit), t'i paguajnë ato online duke shmangur kështu radhët në sportele.

- **“Gjobat e kontrollit teknik vijtor të automjeteve”** është një tjetër shërbim elektronik, i cili ju mundëson të kurseni kohën tuaj. Nëpërmjet këtij shërbimi, qytetarët/bizneset kanë mundësi të shikojnë online gjobat e kontrollit teknik vijtor të automjeteve dhe gjithashtu t'i paguajnë ato online në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt.
- ✚ Shërbimi **“Automjetet e mia”** u vjen në ndihmë të gjithë qytetarëve që duan të verifikojnë të gjitha automjetet që janë nën zotërimin e tyre.
- ✚ Çdo qytetar dhe biznes që zotëron një ose disa mjete, ka mundësinë që nëpërmjet shërbimit elektronik **“Aplikim për certifikatë pronësie mjeti”** të aplikojë online për të marrë certifikatën e pronësisë së mjetit/eve që zotëron si dhe të kryejë online pagesën e tarifës përkatëse. Më pas, mjafton të paraqitet pranë sportelit të drejtorive rajonale dhe mund të kryhet menjëherë tërheqja e certifikatës së pronësisë. Ndërkohë, shërbimi elektronik **“Certifikatë pronësie e mjetit”** shfaq në kohë reale certifikatën e pronësisë së mjetit tuaj.
- ✚ Shërbimet elektronike **“Aplikim për çregjistrim të përkohshëm mjeti”**, **Aplikim për çregjistrim të përhershëm mjeti”**, **“Aplikim për leje qarkullimi ndërkombëtare”** dhe **“Aplikim për leje qarkullimi provizore”** u mundësojnë zotëruesve të automjeteve të aplikojnë online për çregjistrim të përkohshëm/përhershëm të mjetit, për leje qarkullimi ndërkombëtare dhe leje qarkullimi provizore (në rast humbjeje, vjedhjeje ose dëmtimi) si dhe të paguajnë online koston përkatëse të aplikimit pa qenë nevoja të presin në radhë për të kryer një pagesë të tillë.

### 5.6.3. Shërbime që lidhen me shëndetësinë dhe mirëqenien

- ✚ Mjaftojnë disa hapa të thjeshtë për të përfituar kartën e shëndetit online përmes portalit e-Albania. Aplikimi online është i lehtë, i shpejtë dhe eviton humbjen e kohës, ndërsa e gjithë procedura është pa asnjë pagesë apo tarifë shërbimi.

Karta e Shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguar dhe përfiton shërbimet shëndetësore pa pagesë. Ky shërbim ofrohet menjëherë online për të punësuarit, të vetëpunësuarit, për invalidët e plotë, të luftës e invalidët e pjesshëm, veteranët, pensionistët e pensionistët e pjesshëm, të papunët e punëkërkesit, nënat në leje lindje dhe personat që marrin ndihmë ekonomike në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan.




Figura 26. Logoja e kategorisë "Shëndetësia dhe mirëqenia" në portal

Aplikimi për kartën e shëndetit kryhet përmes shërbimit elektronik **“Aplikim për Kartë Shëndeti”**. Duke klikuar butonin "Përdor" qytetari nis procedurën e aplikimit online për



t'u pajisur me kartën e shëndetit. Konfirmon kategoritë specifike të shfaqura në ekran dhe klikon butonin "Apliko", i cili ndodhet në fund të faqes. Pas kësaj procedure aplikuesit do t'i shfaqet mesazhi: *"Sukses! Karta juaj e Shëndetit u gjenerua me sukses me numër (numrin personal të Kartës së Shëndetit). Ju mund ta printoni kartën tuaj te shërbimi: Gjenerimi i Kartës së Shëndetit"*.

Pasi të jetë kryer aplikimi, duke klikuar tek shërbimi ["Gjenerimi i Kartës së Shëndetit"](#), zotëruesi i kartës së shëndetit mund të informohet dhe të konsultojë online të dhënat e kartës së tij të shëndetit, e cila mund të printohet ose shkarkohet menjëherë.

**Kujdes!** Paraprakisht qytetari, përpara se të përfitojë shërbimin "Apliko për Kartë Shëndeti" duhet të jetë i regjistruar pranë mjekut të familjes.

Për kategorinë "Fëmijë" procedura kryhet përmes këtij shërbimi: ["Aplikim për Kartë Shëndeti për fëmijën nga kryefamiljari"](#). Gjenerimi i kartës së shëndetit për fëmijët që e disponojnë një të tillë kryhet përmes shërbimit elektronik ["Gjenerimi i Kartës së Shëndetit për fëmijët nga kryefamiljari"](#).

Për të gjitha kategoritë e tjera qytetari duhet të paraqitet pranë Qendrës së tij Shëndetësore 8 ditë pasi ka kryer aplikimin online, pas orës 14:00 në çdo ditë pune të javës. Nëse data e rezervimit është ditë pushimi (e shtunë, e diel apo ditë feste zyrtare), atëherë rezervimi shtyhet në ditë e parë më të afërt të punës. Aplikimi është i vlefshëm edhe në ditët pasardhëse, por me prioritet normal shërbimi.

Karta e Shëndetit është një ndër hapat për modernizimin e shërbimit shëndetësor, pjesë e reformës së gjithanshme në shëndetësi, që bashkë me recetën elektronike mundëson kontrollin online të sistemit. Përdorimi i kësaj karte përbën një lehtësi edhe për mjekun e familjes, i detyruar deri dje të plotësonte fletë-libreze pa fund, që tashmë të fokusohet tek qëllimi i detyrës së tij: kujdesi ndaj qytetarit.

- ✚ Qytetarët janë të informuar se nga moshë 40-65 vjeç përfitojnë kontroll mjekësor bazë nëpër qendrat shëndetësore të zonës ku banojnë. Mirëpo shumë prej tyre e kanë të vështirë që të drejtohen nëpër qendra për të marrë përgjigjet e analizave të kryera. Ky shërbim u vjen në ndihmë, pasi elektronikisht shtetasit shqiptarë mund të informohen online mbi të dhënat dhe rezultatet e analizave të depistimit mbi Paketën e Detyrueshme të Kontrollit Mjekësor, për moshën 40-65 vjeç nëpërmjet shërbimit elektronik ["Kontrolli mjekësor bazë"](#). Çdo shtetas me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që i përket grupmoshës 40-65 vjeç ka të drejtën e kontrollit mjekësor bazë, pa diskriminim. Kontrolli mjekësor bazë 40-65 vjeç është pa pagesë për shtetasit përfitues të programit, ofrohet dhe realizohet nga punonjësit e shëndetësisë në Kujdesin Shëndetësor Parësor, të kontraktuar nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.
- ✚ Jeta e ngarkuar, rendja e përditshme të bën të lësh pasdore shumë gjëra, ndër to edhe shëndetin. Mirëpo kur paraqitesh para mjekut e ai të pyet për sëmundje që mund të kesh kaluar në të shkuarën, shpesh në moment qytetari/ja mund të harrojë, është konfuz apo jep përgjigje të gabuar lidhur me problemet shëndetësore kronike që ka kaluar më herët gjatë jetës së tij/saj. Nëpërmjet shërbimit elektronik ["Lista e](#)

**sëmundjeve kronike**”, shtetasit shqiptarë mund të informohen online mbi historikun e sëmundshmërive kronike si sëmundjet e zemrës, hipertensionit arterial, veshkave, zorrëve, tëmthit, trurit, tumore etj, të diagnostifikuara pranë mjekut te familjes.

#### 5.6.4. Shërbime që përfshijnë dokumente dhe certifikata

- ✚ Pa asnjë kosto dhe menjëherë, nëse një përdorues i regjistruar i portalit e-Albania hyn te shërbimet **“Të dhënat familjare”** apo **“Të dhënat personale”**, ai/ajo merr një ekstrakt nga Regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në formën e certifikatës familjare apo personale.
- ✚ Shërbimi elektronik **“Formulari i dekriminalizimit”** mundëson publikimin e formularëve të dekriminalizimit për nëpunës të shërbimit civil dhe shërbimit diplomatik, si dhe drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil.



Figura 27. Logo e kategorisë "Dokumente dhe certifikata" në portal

#### 5.6.5. Shërbime për zotëruesit e pronave

- ✚ Çdo qytetar apo biznes, që kërkon të përfitojë leje ndërtimi, duhet të aplikojë online përmes shërbimit elektronik **“Aplikimi për Leje Ndërtimi (e-Lejet)”** nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania. Por si kryhen aplikimet? Aplikimi i dërgohet bashkisë ose Këshillit Kombëtar të Territorit/Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe punonjësit kryejnë përmes sistemit të gjitha verifikimet dhe bashkërendimin me institucionet e tjera publike, të cilat kthejnë përgjigje po nëpërmjet sistemit. Procedura eviton paraqitjen e vërtetimeve nga institucionet e përfshira dhe e gjitha është paracaktuar që të kryhet brenda afateve të qarta dhe pa vonesa.



Figura 28. Logo e kategorisë "Pasuri e Paluajtshme" në portal

Afati i shqyrtimit të lejes së ndërtimit nga bashkia është 15 ditë, ndërsa institucionet e tjera që duhet të japin mendimin e tyre në lidhje me lejen, duhet të përgjigjen brenda 10 ditëve pune. Në rast se institucionet publike nuk i japin përgjigje bashkisë brenda 10 ditëve pune, miratimi/pëlqimi i tyre konsiderohet i dhënë në heshtje dhe bashkia mund të vijojë më tej me shqyrtimin e aplikimit.

- ✚ Për pronën tani mjafton të klikosh – 52 shërbime të **Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme** merren tashmë online përmes portalit qeveritar e-albania. Kopje kartele, kopje harte, vërtetim negativ, vërtetim pozitiv, rivlerësim pasurie; këto janë vetëm katër nga shërbimet në gamën e 52 shërbimeve që janë dixhitalizuar. Gjithashtu

në çdo moment mund të gjurmohet statusi i aplikimit të kryer përmes shërbimit elektronik **[“Gjurmimi i çështjeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”](#)**. 51 shërbimet e tjera aksesohen duke klikuar **[këtu](#)**.

#### 5.6.6. Shërbime të kategorisë së qeverisjes vendore

- ✚ Për të mundësuar konsultimin online të tarifave dhe taksave (të ndriçimit, gjelbërimit, pastrimit etj.), në dispozicion të qytetarëve dhe bizneseve në qytetet Vlorë, Kamëz, Berat, Lushnjë, Sarandë etj. është vendosur shërbimi elektronik **[“Taksat dhe tarifat vendore”](#)**.



Figura 29. Logo e kategorisë "Qeverisja vendore" në portal

#### 5.6.7. Shërbime për të cilat mund të kryhen pagesa online

Të gjithë qytetarët që zotërojnë një kartë krediti ose debiti me logon Visa ose MasterCard, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, kanë mundësinë që nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania të mund të kryejnë pagesa online nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave Elektronike thjesht dhe shpejt, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës. Platforma Qeveritare e Pagesave Elektronike ofron garanci dhe siguri maksimale, lehtësi dhe shpejtësi në veprime, pa qenë nevoja të paraqiteni pranë sporteleve, duke kursyer në këtë mënyrë kohën dhe radhët e gjata të pritjes.

Pagesa të tilla mund të kryhen për:

- ✚ **[“Faturat e energjisë elektrike”](#)**, duke u ardhur kështu në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve që përveçse të gjenerojnë online faturat e papaguara dhe kamatëvonesat e energjisë elektrike, edhe t'i paguajnë ato nëpërmjet portalit, duke shmangur radhët në sportele.
- ✚ **[“Gjobat e kontrollit teknik vjetor të automjeteve”](#)**, **[“Gjobat e kontrollit në rrugë nga DPSHTRR”](#)**, **[“Kundërvajtjet rrugore”](#)** etj. të cilat mund të paguhen lehtësisht online nëpërmjet portalit e-albania.
- ✚ Taksat dhe tarifat vendore për **[qytetarë](#)** dhe **[biznese](#)** (Durrësi) si dhe **[“Taksat e automjeteve”](#)** gjithashtu mund të paguhen në kohë reale, thjesht duke u loguar në llogarinë tuaj në portalin e-albania dhe duke zgjedhur shërbimin për të cilin ju dëshironi të kryeni pagesën.

#### 5.6.8. Shërbime që lidhen me gjurmimin e çështjeve

- ✚ Nëpërmjet shërbimit elektronik **[“Gjurmimi i çështjeve të prokurimit publik”](#)** mundësohet gjurmimi i pjesëmarrjes në tender, në Agjencinë e Prokurimit Publik, të biznesit të loguar. Gjithashtu një biznes i loguar mund të gjurmohet edhe një pjesëmarrje të caktuar në tender në bazë të numrit identifikues që ai zotëron. Informimi rreth një shërbimi të tillë është me interes pasi i bën me dije qytetarit dhe i lehtëson atij punën, i eviton humbjen e kohës etj.



- ✚ Shërbimi elektronik **“Gjurmimi i çështjeve gjyqësore”** mundëson ndjekjen e çështjeve gjyqësore nëpërmjet numrit të protokollit. Thënë më me detaje: mundëson ndjekjen/gjurmimin e çështjeve gjyqësore nëpërmjet sistemit informatik të Gjykatave për Menaxhimin e Çështjeve Civile dhe Penale (CCMIS dhe ICNIS). Nëse hyn brenda këtij shërbimi qytetari gjen listat me çështjet të cilat mund të gjurmohen dhe gjykatat që ofrojnë shërbimin sipas qarqeve.
- ✚ Shërbimet elektronike **“Gjurmimi i çështjeve nga Qendra Kombëtare e Biznesit”** dhe **“Gjurmimi i çështjeve nga Qendra Kombëtare e Biznesit (licenca)”** Gjurmimi i çështjeve nga QKB-ja është një shërbim elektronik, i cili mundëson verifikimin e statusit të çështjes pasi subjekti ka kryer aplikimin pranë sporteve të QKB-së ose nëpërmjet sportelit elektronik (online). Çdo individ, mund të gjurmojë statusin e aplikimit të kryer prej tij në QKB.

#### 5.6.9. Shërbime për pensionistët

- ✚ Për t'i ndihmuar në eliminimin e zgjatjes në kohë të marrjes së pensionit në momentin që një personi i lind e drejta për ta përfituar atë, e-albania i jep mundësi të aplikojë paraprakisht nëpërmjet portalit. Shërbimi **“Kërkesë paraprake për përfitim pensioni pleqërie”** i mundëson të plotësojë online formularin e aplikimit, 1 deri në 12 muaj para se t'i lindë e drejta për përfitim pensioni.
- ✚ Shërbimet që lidhen me “Masat e patërhequra” janë një grup shërbimesh prej nga ku qytetarët e regjistruar mund të marrin të dhëna menjëherë dhe pa asnjë kosto lidhur me: Masat e patërhequra të pensionit familjar apo masat e patërhequra të pensionit shtetëror suplementar të personave me titull shkencor, masat e patërhequra të pensionit të invaliditetit (KMCAP) etj.
- ✚ Nëse një person me titull shkencor, me funksione kushtetuese etj., dëshiron të dijë në rast se do të përfitojë pension shtetëror suplementar, atëherë mund të gjejë detajet e duhura tek shërbimet që lidhen me termin “suplementar” duke kërkuar në fushën e kërkimit në portal.
- ✚ Në bazë të emërtimeve të shërbimeve mund të gjenden menjëherë dhe pa asnjë kosto shtesë të dhëna lidhur me **“Pensionet e patërhequra”**, **“Pensioni i pleqërisë”** etj. Për të marrë vërtetimin online për përfitimin e pensionit mund të kërkonit tek hapësira: ‘Kërko’, shërbimin e emërtuar **“Vërtetim pensioni”**.
- ✚ Për të kryer aplikimin online për një pension të caktuar, sipas statusit aktual në të cilin ndodhet personi i interesuar, mund të kërkohet shërbimi i emërtuar specifikisht si: **“Aplikim për mbyllje pensioni”**, **“Aplikim për pension familjar”** apo detaje lidhur me pensionin. Këto shërbime elektronike iu mundësojnë qytetarëve të aplikojnë online edhe për pensionin suplementar si **pilot, lundruës, akademik** etj.



Figura 30. Logoja e kategorisë "Shëndetësia dhe Mirëqenia" në portal



#### 5.6.10. Shërbime për të punësuarit dhe të papunësuarit

- ✚ Nëse dëshironi të kontrolloni online pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguhen nga punëdhënësi juaj, mjafton të përdorni shërbimin **[“Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit”](#)** duke plotësuar rangun kohor për të cilin dëshironi të shihni këto të dhëna.
- ✚ Shërbimi elektronik **[“Ndhimja ekonomike për individë”](#)** u vjen në ndihmë qytetarëve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, të kontrollojnë online statusin e aplikimit të tyre si dhe të shohin informacion mbi ndihmën që ata kanë marrë gjatë 12 muajve të fundit në qarqet: Tiranë, Durrës, Elbasan.
- ✚ Shërbimi elektronik **[“Aplikim për Vërtetim Pagë Papunësie”](#)** i vë në dispozicion qytetarit mundësinë për të bërë një kërkesë online për lëshim vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare drejt një zyre pune.
- ✚ Shërbimi elektronik **[“Aplikimi për vërtetim si punëkërkuës i papunë”](#)** i vë në dispozicion qytetarit (personave që do të trajtohen me të ardhura nga papunësia) mundësinë për të bërë një kërkesë online për lëshim vërtetimi si punëkërkuës i papunë drejt një zyre pune.

#### 5.6.11. Shërbime OGP (Open Government Partnership - Partneriteti për Qeverisje të Hapur)<sup>2</sup>

- ✚ Nëpërmjet shërbimit elektronik **[“Të dhënat e barnave mjekësore dhe çmimet e tyre”](#)** mund të aksesohet lista e principeve aktive ose emri kimik (emërtimi shkencor) i ilaçit si dhe të shihen elemente të tjera shoqëruese si, formë doza farmaceutike me karakteristikat fiziko-kimike, (pluhur, tabletë, tretësirë, pomadë, ampulë etj.), madhësia e dozës ose sasia e lëndës aktive (vepruese) në formulim, prodhuesit, vendet prodhuese, njësitë e paketimit, çmimi për paketë në lekë, çmimi për njësi në lekë etj.
- ✚ Lista e barnave të rimbursueshme është një pjesë e rëndësishme e paketave të shërbimit që mbulon "Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" për popullatën. Nëpërmjet shërbimit elektronik **[“Lista e çmimeve të barnave të rimbursueshme”](#)**, vizitorët e portalit unik qeveritar e-albania mund të informohen për çmimet e listës së barnave të rimbursueshme në Republikën e Shqipërisë. Shërbimi elektronik shfaq gjithashtu të dhëna shoqëruese si kodin e barit, emrin tregtar, emërtimin kimik, firmën prodhuese, formën, kufizimet etj.

<sup>2</sup> Partneriteti për Qeverisje të Hapur është një iniciativë e shumanshme që synon të sigurojë angazhimin konkret të qeverive për të nxitur transparencën, për të luftuar korrupsionin dhe për të vënë në punë teknologji të reja me qëllim përmirësimin e qeverisjes. Prej vitit 2011 kur u prezantua për herë të parë, OGP numëron sot 66 shtete pjesëmarrëse, mes së cilave edhe Shqipërinë.

- ✚ Në kuadër të implementimit të të dhënave të hapura, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Ministria e Financave ofrojnë nëpërmjet shërbimit elektronik [“Lista e pagesave të kryera nga Degët e Thesarit”](#), për vizitorët e portalit unik qeveritar e-albania mundësinë e informimit për pagesat e kryera nga Degët e Thesarit në Shqipëri. Duke vendosur datën për të cilën vizitori i portalit dëshiron të informohet mbi listën e pagesave, mund të shihen në formë tabele të dhëna që përfshijnë numrin e faturës, emrin dhe kodin e institucionit, drejtorinë dhe ministrinë e linjës, llogarinë dhe përshkrimin e saj, furnitorin, shumën e pagesës, datën e regjistrimit dhe atë të ekzekutimit.

#### 5.6.12. Shërbime për bizneset

- ✚ Fillimi i një biznesi të ri është një proces me shumë hapa që kërkon përkushtim, por mbi të gjitha kohë për të përgatitur të gjithë dokumentacionin e duhur për legalizimin e tij. e-albania e lehtëson këtë proces, duke shkurtuar kohë përmes aplikimit online në portalin e saj si dhe duke shmangur burokracitë përmes shërbimit elektronik [“Regjistrimi fillestar i biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit”](#).
- ✚ Një herë në vit, bizneseve u kërkohet të depozitojnë në regjistrin tregtar pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Depozitimi i dokumenteve të lartpërmendura mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online (pa pagesë) në portalin qeveritar e-albania, përmes shërbimit elektronik [“Depozitimi i bilancit vjetor në Qendrën Kombëtare të Biznesit”](#).
- ✚ Shërbimet [“Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar elektronikisht”](#) u ofrohen përdoruesve të tipit [“biznes”](#) dhe [“gytetar”](#) në portalin qeveritar e-albania për të marrë një informacion të detajuar mbi të gjitha të dhënat e regjistruara si dhe historikun e veprimeve të kryera për çdo subjekt në regjistrin tregtar të QKB-së. Ekstrakti/et gjenerohet/n nga sistemi i QKB-së dhe nënshkruhet/n elektronikisht nga nëpunësit e autorizuar.
- ✚ Shërbimi elektronik [“Regjistrime të tjera të biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit”](#) u vjen në ndihmë bizneseve që aplikojnë për regjistrime të tjera ose ndryshime në të dhënat e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- ✚ Thjesht me anë të një klikimi në shërbimin elektronik [“Lista e pagesave të kryera nga Degët e Thesarit sipas NUIS/NIPT-it”](#), të gjithë përdoruesit e tipit 'biznes', kanë mundësinë e informimit online në kohë reale për pagesat e kryera nga Degët e Thesarit drejt tyre, prej vitit 2012.



Figura 31. Logoja e kategorisë "Biznesi dhe OJF" në portal



- ✚ **“Të dhënat e biznesit”** është një shërbim elektronik dedikuar vetëm përdoruesve të regjistruar si biznes në portalin e-albania. Ky shërbim ofron të dhëna mbi biznesin si forma ligjore, data e regjistrimit, kapitali, adresa, aksionarët, posta elektronike, statusi etj., të dhëna që merren në kohë reale nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- ✚ Nëpërmjet shërbimit elektronik **“Aplikim për licencë të re në Qendrën Kombëtare të Biznesit”** ofrohet mundësia e aplikimit online (person fizik/juridik dhe/ose OJF) për licencë të re (Grupi I dhe II) në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ndërsa shërbimi elektronik **“Aplikim për revokim licence në Qendrën Kombëtare të Biznesit”** ofron mundësinë e revokimit të licencës (Grupi I dhe II) nëpërmjet aplikimit online në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### 5.6.13. Shërbimet e nivelit 1 dhe 2

Shërbimet e nivelit 1 dhe 2 (sipas UNPAN 2014) konsistojnë në informimin e qytetarëve për të gjithë hapat e procedurave për të marrë një shërbim të caktuar, dokumentacionin e nevojshëm, kostot përkatëse në rastet kur aplikohen, oraret, kontaktet (adresa e institucionit, nr. tel apo e-mail), u japin mundësi të interesuarve për një shërbim të caktuar të shkarkojnë paraprakisht formularin që nevojitet të plotësohet për të marrë shërbimin (nëse ka një formular) si dhe butonin që të drejton në faqen përkatëse të institucionit.

#### 5.7. Lista e shërbimeve që do të shtohen brenda muajit qershor 2017 në portalin qeveritar e-albania

Portali qeveritar e-albania është duke u pasuruar me rreth 300 shërbime të reja elektronike të nivelit 3 dhe 4. Ndër to vlejnë të përmenden 51 shërbime elektronike të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (hipoteka) lidhur me pronat (certifikata, vërtetime, regjistrime etj.)<sup>3</sup>, regjistrimi në kopshte/shkolla/gjimnaze, një sërë shërbimesh të reja lidhur me automjetet, shërbime që lidhen me fitimin/rifitimin/lënien e shtetësisë, aplikime për licenca etj.

Gjithashtu brenda vitit 2016 do të shtohen 32 shërbime elektronike të rezervimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore (si psh. rezervime për eko, rezonancë magnetike, skaner etj.).

Projekti “Implementimi i shërbimeve online të Ministrisë së Punëve të Jashtme” do ta pasurojë portalin me 36 shërbime elektronike në dobi të shtetasve shqiptarë jashtë atdheut (si psh. lëshimi i kartave të identitetit/pasaportës, regjistrimi i fëmijëve/martesave etj.).<sup>4</sup>

Në total, në përfundim të projekteve të mësipërme (qershor 2017), portali qeveritar parashikohet të ketë mbi 578 shërbime elektronike të nivelit 3 dhe 4 dhe në total mbi 1000 shërbime të të katër niveleve.

## 6. HAPËSIRA IME

Portali unik qeveritar e-Albania ofron mundësinë e administrimit të hapësirës personale për çdo përdorues. Nëpërmjet “Hapësira Ime” ju mund të:

<sup>3</sup> Shërbimet e ZRPP-së janë shtuar në portal gjatë muajit nëntor 2016

<sup>4</sup> Disa nga shërbimet janë shtuar në muajin nëntor 2016 në portal dhe pjesa tjetër përfundon brenda vitit 2016

- Shikoni listën e e-Shërbimeve në të cilat ju jeni regjistruar dhe i keni përdorur më parë;
- Ndryshoni të dhënat e llogarisë (adresën e-mail, numrin e telefonit, fjalëkalimin) që ju keni regjistruar gjatë procesit të regjistrimit;
- Gjeni listën e të gjithë dokumenteve të shkarkuara në këtë portal;
- Regjistroni biznesin tuaj për t'u loguar më pas nëpërmjet Numrit Unik të Identifikimit (NUIS), gjithashtu i njohur si NIPT dhe fjalëkalimit;
- Gjeni mesazhet e ardhura në llogarinë tuaj;
- Merrni ndihmë për përdorimin e portalit dhe informacionin e plotë mbi regjistrimin në portalin unik qeveritar e-Albania, përdoruesit dhe mënyrat e identifikimit si dhe aksesimin;
- Shikoni listën e pagesave elektronike në lidhje me faturat e energjisë elektrike të paguara online në portalin qeveritar e-albania;
- Shikoni listën e të gjitha pagesave elektronike të kryera online në portalin qeveritar e-albania.

Pasi të jeni loguar, klikoni në "Hapësira Ime".



Figura 32. Aksesimi i "Hapësirës sime"






Figura 33. Opsionet e seksionit "Hapësira ime"

- **e-Shërbimet e mia**  
Këtu gjenden shërbimet që përdoruesi ka përdorur në historikun e veprimeve të tij në portal.




Figura 34. Nënseksioni "Shërbimet e mia" në seksionin "Hapësira ime"

- **Të dhënat personale**

Te kjo hapësirë, përdoruesi mund të ndryshojë adresën e-mail-it, të cilën ka përdorur për t'u regjistruar, numrin e telefonit dhe fjalëkalimin.

**Të dhënat personale**

Emri  
Blanca Kallari

Adresa e-mail  
blanca.kallari@gmail.com

Numri i telefonit  
069 123456

Fjalëkalimi (Plotëso vetëm nëse dëshiron ta ndryshosh)

Fjalëkalimi përsëri

Ruaj

Figura 35. Nënseksioni "Të dhënat personale" në seksionin "Hapësira ime"

- **Dokumentet e mia**

Këtu përdoruesi mund të gjejë listën e të gjithë dokumenteve të shkarkuara prej tij në portal.

**Dokumentat e mia**

Skedari	Veprime
Certifikata-Personale-I06103084L-12052015.pdf	Shkarko
Certifikata-Personale-I06103084L-13052015.pdf	Shkarko
Certifikata-Personale-I06103084L-13062016.pdf	Shkarko

Figura 36. Nënseksioni "Dokumentet e mia" në seksionin "Hapësira ime"

- **Regjistrimi i biznesit tuaj**

Përdoruesi i portalit mund të regjistrojë në këtë hapësirë biznesin e tij, për t'u loguar më pas nëpërmjet NUIS dhe fjalëkalimit.




The screenshot shows a web form titled "Regjistrimi i biznesit tuaj". The form is divided into a header section "Të dhënat e biznesit" and a main input area. The input area contains several fields: "NUIS:" with an information icon, "Fjalëkalimi (Minimumi 7 karaktere):", "Fjalëkalimi përsëri:", "e-mail:", "Nr. Celularit: (Formati 06xxxxxxxx)", "Emri biznesit:", and "Pyetja e sigurisë:" with a dropdown menu showing "Vendlindja e nënës".

Figura 37. Regjistrimi i biznesit në seksionin "Hapësira ime"

- **Mesazhet e mia**

Në këtë hapësirë gjenden mesazhet që përdoruesi ka marrë gjatë përdorimit të portalit.



The screenshot shows a web page titled "Mesazhet e mia". The main content area is empty and contains the text "Ju nuk keni asnjë mesazh!". At the bottom, there is a navigation menu with links: "Rreth portalit", "Rreth Shqipërisë", "e-Shërbime", "Kategoritë", "Institucionet", "Lajme", "Forumi", "Hapësira ime", "Politikat e Privatësisë", "Kushtet e përdorimit", "Info të dobishme", and "Kontakt".

Figura 38. Nënseksioni "Mesazhet e mia" në seksionin "Hapësira ime"

- **Ndihmë për përdorimin e portalit**

Në këtë hapësirë përdoruesi merr ndihmë në përdorimin e portalit për regjistrimin, mënyrat e identifikimit, aksesimin, informacione për kryerjen e pagesave elektronike etj.






Figura 39. Nënseksioni "Ndihmë për përdorimin e portalit" në seksionin "Hapësira ime"

- **Libreza ime e dritave**

Këtu gjendet libreza online e energjisë elektrike dhe historiku i faturave online të paguara të paguara si abonent i OSHEE-së.



ID	Kodi i Klientit	Numri i faturës	Kamata <sup>Ⓛ</sup>	Detyrim <sup>Ⓛ</sup>	Totali i paguar <sup>Ⓛ</sup>	Data/Ora	Banka	Transaksioni
1	TR1B03	632595858	38.30	0	38.3	18.2.2016 14:54:21	CREDINS	13f1e584C29137A23E643A3B5...
2	TR1B03	630205231	0	7202.20	7202.2	28.10.2015 21:38:13		4C64573239954EE6AA978...
3	TR1B03C	629017460	0	9721.60	9721.6	8.9.2015 13.01:39	BKT	1C73C1D97992409892AC...

Ky informacion është siguruar nëpërmjet platformës qeveritare të pagesave elektronike, administruar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit - <http://www.e-albania.ai>

Figura 40. "Libreza ime e dritave" në seksionin "Hapësira ime"

- **Pagesat e mia**

Lista e të gjitha pagesave online të kryera përmes portalit e-Albania

Pagesat e mia

Pagesat OSHEE

Shërbimi	Data	Kontrata	Seria	Vlera
Faturat e energjisë elektrike	18.2.2016 14:54:21	TR1B03	632595858	38.3
Faturat e energjisë elektrike	28.10.2015 21:38:13	TR1B03	630205231	7202.2
Faturat e energjisë elektrike	8.9.2015 13:01:39	TR1B03	629017460	9721.6

Figura 41. "Pagesat e mia" në seksionin "Hapësira ime"

Informacioni mbi "Hapësirën time" gjendet në: <https://e-albania.al/hapesiraime.aspx>

## 7. FORUMI

Forumi i portalit unik qeveritar e-Albania ju vjen në ndihmë qytetarëve me dy rubrikat:



Figura 42. Aksesimi i forumit nga faqja kryesore e portalit

- **“Pyetjet më të shpeshta”**, ku gjenden përgjigjet e pyetjeve që janë bërë më shpesh nga përdoruesit e portalit e-Albania.
- **“Rreth e-albania”**, ku qytetarët mund të dërgojnë pyetje apo sugjerime mbi funksionimin e portalit e-Albania.



Figura 43. Përbërja e kategorive të forumit

## 8. APLIKACIONI MOBILE E-ALBANIA PËR IOS DHE ANDROID

Aplikacioni mobile e-Albania është ndërtuar duke iu përshtatur infrastrukturës së Platformës Qeveritare të Ndërveprimit dhe portalit e-Albania.

Aplikacioni shfaq në format të përshtatur për pajisjet mobile, të gjitha shërbimet e portalit, si edhe funksionet e tjera të tij, lajmeve, foto e video galeritë, ndryshimi i të dhënave personale, konsultimi i shërbimeve të përdorura më parë, etj.

Një avantazh i aplikacionit mobile, është dërgimi i njoftimeve (push notifications) për të lajmëruar përdoruesit për shërbime të reja apo lajmërimet e tjera të rëndësishme.

Më poshtë shpjegohen ndërfaqet kryesore të aplikacionit mobile.



Figura 44. Imazhi hyrës i aplikacionit mobile




Figura 46. Pasqyrimi i shërbimeve në total, shërbimet më të përdorura, shërbimet me pagesë, shërbimet për qytetarët, shërbimet për bizneset dhe ato për administratën





Figura 45. Listimi i shërbimeve në total të publikuara në portalin e-Albania



## Aplikim për Kartë Shëndeti

Përdor

Nëpërmjet këtij shërbimi, qytetarët mund të aplikojnë online për t'u pajisur me Kartë Shëndeti.

Bazuar në Vendimin e Qeverisë, nr.307, datë 21.05.2014 për "Regjistrimin dhe Identifikimin e Personave të Siguruar nga Sigurimi i Detyrueshëm Shëndetësor", identifikimi i personave të siguruar në Skemën e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, bëhet me anë të Kartës së Shëndetit. Karta e Shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar dhe përfiton shërbimet shëndetësore pa pagesë. Karta është personale, e patjetërsueshme dhe shpërndahet pa asnjë

Figura 47. Shembull për përdorimin e një shërbimi elektronik përmes aplikacionit e-Albania



Figura 48. Identifikimi i qytetarëve/bizneseve nga aplikacioni mobile



## 9. SPORTELET DIXHITALE E-ALBANIA

### 9.1. Çfarë janë sportelet dixhitale e-albania dhe cilat janë përfitimet prej tyre?

Sportelet dixhitale e-albania tashmë ndodhen në pikat kryesore të Shqipërisë për të bërë të mundur aksesimin e portalit më të lehtë për qytetarët.

Nëpërmjet shpërndarjes së sporteve dixhitale, portali unik qeveritar e-Albania synon të ofrojë akses dhe kërkim më të lehtë në internet për qytetarët apo grupet e tjera të interesuara të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesi publik për të marrë informacion apo shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Sporteli dixhital i shërbimeve publike do të ofrojë nëpërmjet automatit shërbime publike 24/7.

Nga përdorimi i sporteve interaktive qytetarët, bizneset apo grupet e tjera të interesit përfitojnë: shmangie të radhëve, pritjeve të gjata në sportelet e institucioneve të ndryshme, pagesat direkt duke përdorur sportelet dixhitale pa qenë e nevojshme të bëhen pagesat në sportelet e bankave, etj.

Për t'u dhënë mundësinë palëve të interesuara, që të përdorin dhe përfitojnë edhe shërbimet elektronike që ofrohen në portalin e-Albania, sportelet dixhitale janë të pajisura me:

- Lexues të kartës së identitetit
- Lexues kartave të bankave (Karta Krediti/Debiti)



Figura 49. Foto e sportelit dixhital dhe portave hyrëse/dalëse të tij





- Printer termal për faturë - mandat pagese
- Printer termal A4 për fatura/certifikata apo vërtetime
- Kompjuter
- Ekran multitouch
- UPS
- USB

Impakti që sjell përdorimi i sporteve dixhitale:

- Reduktimi i radhëve të gjata
- Shmangia e burokracisë dhe ulja e korrupsionit
- Mundësia për të marrë shërbimet informative/elektronike në 24/7 nëpërmjet automatit
- Rritje e efikasitetit ndaj qytetarëve, bizneseve, grupeve të tjera të interesit në përshejtimin e procesit të marrjes së shërbimeve informative apo elektronike
- Pagesa online me kartë krediti/debiti dhe nëpërmjet kanaleve jo-bankare që ofrohen nga Platforma Qeveritare e Pagesave Elektronike.

## 9.2. Vendndodhjet e sporteve dixhitale në Shqipëri

Nr.		Vendndodhja e sportelit
<b>TIRANË (5 sportele dixhitale në total)</b>		
1	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	
2	Qendra Kombëtare e Bizneseve	
3	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara – ADISA (sportelet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme)	
4	Bashkia Tiranë	
5	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	
<b>DURRËS (1 sportel dixhital në total)</b>		
6	Flagship Center	
<b>VLORË (1 sportel dixhital në total)</b>		
7	Bashkia Vlorë	
<b>SARANDË (1 sportel dixhital në total)</b>		
8	Bashkia Sarandë	
<b>SHKODËR (1 sportel dixhital në total)</b>		
9	Bashkia Shkodër	
<b>MALËSI E MADHE (1 sportel dixhital në total)</b>		
10	Bashkia Malesi e Madhe	
<b>KORÇË (1 sportel dixhital në total)</b>		
11	Bashkia Korçë	
<b>ELBASAN (1 sportel dixhital në total)</b>		
12	Bashkia Elbasan	

<b>KAVAJË (1 sportel dixhital në total)</b>	
<b>13</b>	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara – ADISA Kavajë (së shpejti)
<b>FIER (2 sportele dixhitale në total)</b>	
<b>14</b>	ETC Fier
<b>15</b>	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara – ADISA Fier (së shpejti)




Figura 50. Harta e sporteve dixhitale e-albania në Shqipëri




Figura 51. Foto nga ambientet e institucioneve ku janë vendosur sportelet dixhitale e-albania



## 10. PANELI I ADMINISTRIMIT NË BACKEND-IN E PORTALIT QEVERITAR E-ALBANIA

Paneli i administrimit në backend-in e portalit qeveritar e-Albania shërben për të përditësuar dhe ndryshuar përmbajtjen e portalit, duke shtuar në të shërbime të reja, lajme, institucione, etj. Paneli ka tre nivele përdoruesish, sipas hierarkisë së mëposhtme:

- 1- **Krijues:** Ka mundësi të shtojë shërbime apo artikuj të rinj, por jo t'i publikojë ato në portal. Informacionet kanë nevojë të miratohen nga një përdorues i një niveli më të lartë, për t'u shfaqur në portal.
- 2- **Miratues:** Ka mundësi të aprovojë informacionin e ngarkuar nga përdoruesit e nivelit 'krijues'.
- 3- **Administrator:** Ka kontroll mbi të gjithë funksionet e panelit të administrimit, përfshi krijimin e përdoruesve të rinj.

Personat e autorizuar për përdorimin e panelit të administrimit caktohen nga çdo institucion që ka për detyrë pasqyrimin e shërbimeve të ofruara prej tij në portalin e-Albania. Për tipet 1 dhe 2 të përdoruesve, ekziston mundësia që atyre t'iu jepet akses vetëm për një institucion të caktuar. Paneli i administrimit mund të aksesohet vetëm brenda rrjetit qeveritar GovNet. Autentifikimi kryhet duke përdorur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e tij si përdorues qeveritar në Active Directory të GovNet.

Funksionet kryesore të panelit të administrimit janë:

- Shtimi i shërbimeve të reja
- Modifikimi/fshirja e shërbimeve ekzistuese
- Shtimi i dokumenteve attach në shërbime
- Publikimi i shërbimeve
- Shtimi i artikujve të lajmeve
- Modifikimi/fshirja e artikujve ekzistues të lajmeve
- Shtimi i institucioneve publike
- Modifikimi/fshirja e institucioneve publike
- Shtimi/ndryshimi i parametrave të ndryshëm të portalit (kategoritë e shërbimeve, gjuhët, etj)
- Moderimi i forumit
- Historiku i ndryshimeve të një shërbimi
- Menaxhimi i listës së përdoruesve qeveritarë me akses në panelin e administrimit
- Raportimi i statistikave të ndryshme rreth përdoruesve (numri i përdoruesve të regjistruar sipas datës) dhe shërbimeve (përdorshmëria e shërbimeve, pagesat e shërbimeve etj.)

## 11. INFRASTRUKTURA E PORTALIT

Portali është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway – GG), një zgjidhje e mbështetur në teknologji Microsoft, platform independent, e cila përdor BizTalk

Server dhe është e lidhur me të gjitha institucionet që kanë back-end. Kështu, komponentët kryesorë të e-albania janë:

- a) Platforma Qeveritare e Ndërveprimit
- b) Ofruesit e shërbimeve
- c) Portali front-end
- d) Portali back-end
- e) Platforma Qeveritare e Pagesave Elektronike
- f) Infrastruktura e çelësit publik.

Portali unik qeveritar, nëpërmjet ndërveprimit të të gjitha bazave të të dhënave shtetërore dhe ndërfaqësimit unik të tyre në një platformë të vetme, ofron shërbime elektronike në kohë reale, pa pasur nevojë që për të dhënat dytësore të kërkuara nga një shërbim, të drejtohesh pranë zyrave të ndryshme të administratës publike.

Skema e ofrimit të shërbimeve elektronike paraqitet më poshtë.




Figura 52. Skema e ofrimit të shërbimeve elektronike